

“Ulja e krimit mjedisor nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese, në Parkun Kombëtar të Tomorrit”

Denoncime publike mbi demet ne mjedis-Berat

Ne aktivitetin e dates 10 Janar, te zhvilluar ne institucione shtetore ne Berat: Bashki, AdZM, ISHMP u perfshine 12 perfaqesues te institucioneve te lartpermendura. Keto takime erdhen si rezultat I denoncimeve te qytetareve te sensibilizuar ne kuader te projektit qe organizata “Per Mireqenie Sociale dhe Mjedisore” zbaton ne qytetin e Beratit, si pjese e programit ACHIEVE- REC Shqiperi, financuar nga Bashkimi Evropian.

Faqja e web-it e organizates ka mundur te mbledh disa denoncime qe ngrihen si shume shqetesuese per qytetaret. Materialet e prezantuara erdhen per syte e punonjesve te administrates shtetore ne forem videosh. Ato flisnin qarte per ndotje te lumit Osum (dy raste), me mbetje te te gjitha llojeve ne dy dite te ndryshme e materiali i trete ishte nje montazh i pergatitur nga ne mbi krimin mjedisor te bere ne vite ne malin e shenjte Tomorr.

Videot u prezantuan si denoncime direkte e u adresuan per Bashkine Berat dhe videoja e trete per AdZM dhe ISHMP. Keto video jane bere publike edhe gjate muajit dhjetor ne media sociale, sikurse edhe ne media lokale ne Berat.

N/Kryetarja e Bashkise - Berat, Zj Teuta Mucogllava ne fund te pamjeve te ndjekura premtoi se do t i ndiqte rastet e ndotjes e do te ngrinte edhe nje grup te posacem “Task Force”te perbere nga perfaqesues te disa institucioneve per te na kthyer nje pergjigje per rastin ne fjale. Ajo shprehu indinjaten per ndotjen e Osumit dhe u shpreh e hapur per cdo rast te denoncuar edhe ne vazhdimesi.

Ne ISHMP takimi vazhdoi me tre inspektore te mjedisit me te cilet u bashkebisedua mbi veshtiresite e punes se tyre gjate inspektimeve ne malin Tomorr, rezultateve te arritura nga grupi i “krimit financiar” i lokalizuar ne kete zone e shqetesimit te ngritur nga nje banor i zones gjate vizites sone ne zone-mbi perdorimin e eksploziv ne Novaj. Ata nuk u prononcuan per kete e na siguruan qe nje gje e tille nuk eshte e mundur pasi vete firmat nuk jane te interesuara ta therrmojne gurin i cili eshte ne sipërfaqe te malit.

Ne AdZM, takimi u percoll nga pese perfaqesues te saj, ku tema e diskutimit ishte krimi mjedisor ne malin Tomorr, prishja e rende e flores , faunes, cenimi i parikthyeshem i biodiversitetit te ZM ne disa zona ku ajo shtrihet (zona tampon).

Nga ana e AdZM- sipas inspektoreve, eshte bere nje pune shume e madhe megjithe veshtiresite e shumta ne terren, raste flagrante te ngritura nga ana e tyre ka patur, por inspektoriati eshte ai qe i shqyrton ato. Pra raste abuzimi ka individe apo edhe firma shrytezimi te gurit, por kopetencat kalojne te nderthurrura midis institucioneve e gjithesejcili pretendon se rastet i con deri ne fund, por pa rezultate te dukshme. Ata vune theksin se ishin ne pritje te draftit perfundimtar te ligjit te ZM i cili rregullon e forcon edhe kopetencat e tyre si dhe procesin e gjobevenieve. Gjithashtu ata vune theksin se Zonat e mbrojtura per t u mbrojtur nuk duan vetem vullnetin e punonjesve por mbi te gjitha vullnet politik e sensibilizim te te gjithe banoreve, e pse jo edhe policim te vete atyre.

Ne takime ishte e pranishme edhe Zj Dorina Gozhina – perfaqesuese e Avokatit te Popullit ne Berat. Asaj do i përcillen te tre rastet e denoncuar qe edhe do te ndiqen me pas nga Avokati i Popullit ne menyre te pavarur.

Erjola Azizolli

Menaxhere e projektit ACHIEVE, Berat

Organizata “Per Mireqenie Sociale dhe Mjedisore”